

SONDAZHI I MESIMIT ONLINE 2

Perceptime të nxënësve, prindërve dhe mësuesve



Prill, 2020



00 PËRMBAJTJA



01 PËRMBLIDHJE EKZEKUTIVE

HYRJE

Situata e krijuar nga pandemia Covid-19 vijon të detyrojë Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) të mbajë mbyllur të gjitha institucionet arsimore që nga data 9 mars 2020, për të parandaluar përhapjen e mëtejshme të virusit dhe për të mbrojtur shëndetin e qytetarëve. Ende nuk dihet data e saktë e hapjes së shkollave apo nëse ato do të qëndrojnë të mbyllura për një periudhë të gjatë kohore.

Për të shmangur mbetjen prapa në mësimet të nxënësve, si dhe për të krijuar mundësinë e përfundimit të vitit shkollor, MASR në bashkëpunim me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP), e kaluan gjithë procesin mësimor nga shkolla tek mësimi në kushte shtëpie. Dy forma kryesore mësimore po zbatohen: leksione të xhiruara dhe të transmetuara në Radio Televizionin Shqiptar (RTSH) dhe puna mes nxënësve dhe mësuesve përmes rrjeteve sociale apo platformave të ndryshme që mundësojnë krijimin e klasave virtuale (google classroom, google hangout, edmodo, zoom etj.).

Mund të ketë disa forma apo mënyra se si mund të vlerësohet angazhimi i palëve në këtë proces, efektshmëria e tij, si dhe mënyra e zbatimit të tij. Një nga mënyrat më të shpejta të vlerësimit të këtij procesi është nëpërmjet sondazhit online në një popullatë të gjerë (kampion i qëllimshëm). Pas sondazhit të parë online të kryer në datat 22-26 mars 2020, ASCAP hartoi dhe përmes DPAP-së administroi një sondazh të dytë me mësues, nxënës dhe prindër, për mësimin online.

PËRMBLDHJE EKZEKUTIVE

Sondazhi nr. 2 është administruar online në datat 4-7 prill 2020. Rreth 219.590 individë kanë plotësuar sondazhin dhe përgjigjet i gjeni të bashkëlidhura në këtë tekst. Falënderojmë të gjithë nxënësit, prindërit dhe mësuesit që përsëri ndanë kohën e tyre dhe morën pjesë në këtë sondazh të rëndësishëm për mbarëvajtjen e mësimit në kushtet e shtëpisë.

Gjetjet e sondazhit nr 2. tregojnë se mësuesit po zbatojnë mënyra të reja të procesit të mësimit dhe po bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, nxënësit po përballen me mënyra të reja të nxënies dhe shumë prindër po e gjejnë veten me një titull të ri, të papritur dhe sfidues *“Mësues”*.

Situata e krijuar nga COVID-19 jo vetëm ka ndërgjegjësuar të gjithë qytetarët, por mbi të gjitha vijon të rrisë bashkëpunimin mësues - prindër - nxënës. Pavarësisht vështirësive dhe kushteve në të cilat ndodhemi, sondazhi nr 2 rikonfirmim faktin se procesi i shkëmbimit të informacionit ndërmjet këtij trinomi nëpërmjet rrjeteve sociale, platformave të ndryshme online është më i miri i mundshëm që mund të realizohet, në mënyrë që fëmijët të vijojnë me realizimin e njohurive dhe të aftësive që kërkon kurrikula.

Është i qartë fakti se prindërit nuk janë mësues dhe mund të ndjehen të mbingarkuar nga presioni për t'i ndihmuar fëmijët e tyre që të përvetësojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme gjatë kohës që shkollat janë mbyllur, por megjithatë në këto momente klasa virtuale dhe komunikimi online me mësuesit dhe me shokët e tyre është mënyra e vetme për të vijuar me procesin e mësimit.

PËRMBLDHJE EKZEKUTIVE

ANALIZA E GJETJEVE

Një numër i madh nxënësish, prindërisht dhe mësuesish morën pjesë në këtë sondazh. Bazuar në të dhënat e tre pyetësorëve rezultoi se në sondazh morën pjesë: 120.926 nxënës; 75.783 prindër; 22.881 mësues.

Në total për të tria instrumentet janë përfshirë 219.590 persona. Është e rëndësishme të nënvizohet se sondazhi është administruar tek mësuesit, nxënësit dhe prindërit e nxënësve të klasave 1-12, kryesisht në arsimin publik parauniversitar. Sondazhi NUK është përdorur tek arsimi parashkollor.

Nga analiza e gjetjeve kryesore, ajo që vihet re dhe që përputhet me informacionin që MASR merr çdo ditë nga DPAP, është se një numër shumë i konsiderueshëm i nxënësve, prindërve dhe mësuesve të kampionit të marrë në studim, janë angazhuar në mësimet online, përkatësisht: 96.% e nxënësve, 95.2 % e prindërve dhe 96.4 % e mësuesve.

Bazuar në rezultatet e sondazhit, telefoni i zgjuar është pajisja më e përdorshme për të zhvilluar mësimet online. Rreth 95.7% e nxënësve (nga të cilët 36.6% në fshat dhe 59.1% në qytet), 96.8% e prindërve (nga të cilët 31.1% në fshat dhe 65.7% në qytet) dhe 95.9% e mësuesve (nga të cilët 45.8% në fshat dhe 50.1% në qytet) zhvillojnë mësimin në kushtet e shtëpisë duke përdorur telefonin e zgjuar (celular). Ndërkohë, për të zhvilluar detyrat apo testet gjatë mësimin në kushtet e shtëpisë, 2.2% e nxënësve përdorin tabletët, 1.2% e nxënësve përdorin laptopët dhe 0.9% e nxënësve përdorin kompjuterët.

PËRMBLDHJE EKZEKUTIVE

Mësimet e transmetuara në programin televiziv “RTSH Shkolla” vijnë të ndiqen nga pjesa më e madhe e nxënësve, prindërve dhe mësuesve, përkatësisht nga 78.9% e nxënësve, 79.9% e prindërve dhe 96.4% e mësuesve. Nxënësit që nuk kanë arritur të shohin transmetimet, i ndjekin videot te kanali *Youtube* i MASR-së (51.1% e nxënësve) apo edhe tek platforma *akademi.al* (61.3% e nxënësve).

Mësimi online në kushtet e shtëpisë, megjithëse nuk mund ta zëvendësojë mësimin në klasë, ka krijuar mundësi që nxënësit të punojnë dhe të krijojnë të pavarur në kushtet e shtëpisë duke përdorur burime digjitale alternative. Sot nxënësit rriten me teknologji dhe ky burim është lehtësisht i përdorshëm për ta. 66.5% e prindërve pohojnë se fëmijët e tyre po zhvillojnë kompetencën digjitale duke zbatuar mësimin online.

Referuar rezultateve të sondazhit 2, mësuesit kanë zbatuar udhëzimet e MASR-së dhe të ASCAP-it, lidhur me lehtësimin e ngarkesës përmbajtësore mësimore. 96.5% e mësuesve deklarojnë se kanë qenë fleksibël dhe e kanë parë me shumë përparësi lehtësimin e ngarkesës përmbajtësore me nxënësit, duke u përqendruar më së shumti te përsëritja e njohurive të fituara deri tani, si dhe te trajtimi i disa njohurive dhe aftësive kryesore të reja.

Për të siguruar efektivitetin gjatë mëimit në kushtet e shtëpisë, mësuesit nëpërmjet mesazheve, powerpoint-eve apo videove të përgatitura, japin udhëzime, detyra, ushtrime, lexime plotësuese, mini teste etj., në varësi të temave mësimore dhe të specifikave të lëndës, si dhe u përgjigjen pyetjeve që

PËRMBLDHJE EKZEKUTIVE

bëjnë nxënësit në lidhje me temat mësimore dhe me vështirësitë e paqartësitë që ata kanë. Këtë e pohojnë 96% e mësuesve dhe 87.3% e nxënësve.

Trajtimi i nxënësve sipas nevojave të tyre ka qenë një tjetër parim shumë i rëndësishëm gjatë mësimit në kushtet e shtëpisë. 93.9% e mësuesve kanë treguar fleksibilitet në trajnimin e nevojave të nxënësve duke iu dhënë atyre detyra specifike, si dhe duke i udhëzuar ata në mënyrë të veçantë për kryerjen e tyre.

Gjatë periudhës në të cilën është kryer sondazhi nr 2, pjesë e mësimit online në kushtet e shtëpisë ka qenë edhe vlerësimi i nxënësit, si një nga komponentët më të rëndësishëm të kurrikulës. Nga të dhënat e grumbulluara rezultojnë se 96 % e nxënësve shprehin "*Shumë dakord*" dhe "*Dakord*" se vlerësohen nga mësuesit gjatë procesit të mësimit online. Kjo e dhënë përputhet dhe me të dhënat e kategorisë së mësuesve, pasi 91.5% e tyre pohojnë se kanë kryer vlerësime për periudhën e dytë gjatë mësimit online në kushtet e shtëpisë. Lidhur me realizimin e testeve/ detyrave përmbledhëse apo të detyrave krijuese/hulumtuese të portofolit në kushtet e shtëpisë, rezultojnë se 98.3% e nxënësve i kanë kryer ato. Rreth 88.4 % e nxënësve pohojnë se mund t'i përfundojnë detyrat gjatë mësimeve të zhvilluara përmes komunikimit online dhe 91.8% e prindërve janë në dijeni të faktit se fëmijët e tyre kanë marrë vlerësim online nga mësuesit. Në përfundim të periudhës së dytë të vitit shkollor janë realizuar tri vlerësimet e kësaj periudhe. 97.3% e mësuesve deklarojnë se i kanë përfunduar këto vlerësime, i kanë diskutuar me nxënësit dhe prindërit, si dhe i kanë dorëzuar në drejtorinë e shkollës.

PËRMBLDHJE EKZEKUTIVE

Për të ndihmuar nxënësit në përmirësimin e rezultateve të tyre gjatë mësimin në kushtet e shtëpisë, mësuesit vazhdimisht i vlerësojnë nxënësit për detyrat e shtëpisë, punët e pavarura etj., duke iu komentuar atyre arritjet më të mira dhe duke i udhëzuar për përmirësimin e përparimit të tyre. 96% e mësuesve e pohojnë këtë duke përdorur instrumente dhe forma vlerësimi, të cilat janë në përputhje me nevojat e veçanta, karakteristikat dhe mundësitë e nxënësve, ndërkohë që ky rezultat mbështetet edhe nga 91.8% e prindërve dhe 90% e nxënësve.

Megjithëse 13.3% e mësuesve dhe 16.1% e prindërve janë *pjesërisht dakord* që komentet dhe vlerësimet online kanë motivuar nxënësit dhe kanë nxitur përmirësimin e tyre, 84.5% e mësuesve dhe 76.4% e prindërve shprehën "*Dakord*" dhe "*Shumë dakord*" që vlerësimi i mësuesve ka ndikuar në motivimin dhe në përmirësimin e nxënësve. Gjithashtu 82% e mësuesve shprehën të kënaqur me pjesëmarrjen dhe angazhimin e nxënësve në mënyrat e reja të vlerësimit të vazhduar, vlerësimit të portofolit dhe vlerësimit me test ose me detyrë përmbledhëse. Vlerësimi i portofolit për periudhën e dytë është përshtatur nga mësuesit duke u krijuar mundësi nxënësve të zhvillojnë detyra krijuese ose hulumtuese që mund të zhvillohen në kushtet e shtëpisë. 91.5% e mësuesve e kanë realizuar këtë formë vlerësimi e cila është mbështetur nga 75.8% e nxënësve.

Bazuar në udhëzimet e MASR-së dhe të ASCAP-it, 97% e mësuesve kanë realizuar testet apo detyrat përmbledhëse nëpërmjet komunikimit online ose të drejtpërdrejtë duke mos krijuar mbingarkesë për

PËRMBLDHJE EKZEKUTIVE

nxënësit. 80.6% e mësuesve shprehen *"Dakord"* dhe 15.7% e tyre janë *pjesërisht dakord* se ky lloj vlerësimi ka qenë efektiv për nxënësit, ndërkohë që këto rezultate janë në të njëjtën linjë me rezultatet e prindërve për këtë çështje (73.3% shprehen *"Dakord"* dhe 18.7 shprehen *"Pjesërisht dakord"*), si dhe me rezultatet e nxënësve (81.4% shprehen *"Dakord"* dhe 11.1% e tyre shprehen *"Pjesërisht dakord"*).

Në këtë situatë partneriteti mësues - prindër - nxënës ka marrë një rëndësi tepër të veçantë për ta bërë këtë proces sa më efektiv. Një nga faktorët e rëndësishëm gjatë zhvillimit të mësimit në kushtet e shtëpisë ka qenë komunikimi i rregullt i mësuesve me nxënësit dhe me prindërit e tyre, si dhe me drejtuesit e institucionit arsimor duke i informuar ata për vlerësimet e nxënësve dhe mënyrat e përmirësimit të të nxënësve. 92.3 % e mësuesve dhe 88.8% e prindërve e konfirmojnë këtë. Mësimi online u mundëson nxënësve të zhvillojnë kompetencën digjitale, por njëkohësisht ata kanë mundur të ndajnë shqetësime, probleme, nevoja, diskutime që nuk kanë të bëjnë vetëm me të mësuarin, por dhe me çështje të tjera që ndikojnë në aspektin social-emocional të nxënësve.

Mësimi online në kushtet e shtëpisë i ka bërë mësuesit të ndjekin më shumë platforma trajnime online duke zhvilluar kapacitetet e tyre profesionale në këtë fushë. Trajnimi i mësuesve për zhvillimin e kompetencave digjitale nga njëra anë ka qenë një nga fushat më prioritare për të zhvilluar shkollat e shekullit XXI, por nga ana tjetër është pjesa më e vështirë për mësuesit. ASCAP, në bashkëpunim me kompaninë *"TeachPitch"*, ka kryer trajnime online falas për mësuesit, lidhur me përdorimin e platformave online për zhvillimin e mësimit në kushtet e shtëpisë. Trajnimi ka filluar gjatë muajit mars

PËRMBLDHJE EKZEKUTIVE

dhe do të vijojë edhe gjatë muajit prill. Aktualisht janë trajnuar 1550 mësues dhe pritet të trajnohen rreth 7000 mësues. Ky trajnim është pritur shumë mirë nga mësuesit dhe është deklaruar nga ana e tyre se ka qenë shumë efektiv dhe i vlefshëm për organizimin e mësimit online.

Se fundmi, vlen për tu theksuar fakti se angazhimi i mësuesve në mësimin online i përballi ata me sfida të reja. Ata duhet të përshtasin stilet e mësimdhënies duke marrë parasysh nevojat dhe mundësitë e nxënësve, si dhe duhet të zotërojnë njohuri dhe aftësi në përdorimin e teknologjisë. Pavarësisht sfidave, mësimi online është e ardhmja për shkollat e shekullit XXI dhe me gjithë përballjen e menjëhershme të mësuesve dhe të nxënësve me këtë lloj mësimi, ai do të shërbejë në të ardhmen si burim i rëndësishëm i procesit të të nxënësve.

PËRMBLHDHJE EKZEKUTIVE

QELLIMI I SONDAZHIT

- të vlerësojë efektivitetin e procesit të vlerësimit në kushte shtëpie.

- të orientojë vendimmarrje që mbështeten në të dhëna

VLERËSIMI

ORIENTIMI

VLERËSIMI

NXITJA E
DIALOGUT

- të vlerësojë efektivitetin e mësimit në kushtet e shtëpisë dhe të formave të zhvilluara nga mësuesit, parë këta nga këndvështrimi i nxënësve, prindërve dhe mësuesve.

- të nxitë dialogun mes nxënësve, prindërve dhe mësuesve me qëllim përmirësimin e mësimit në kushtet e shtëpisë.

02 METODOLOGJIA

3 instrumente

- Instrumenti i nxënësve - 17 pohime
- Instrumenti i prindërve - 15 pohime
- Instrumenti i mësuesve - 29 pohime

KAMPIONIMI

INSTRUMENTET

- Kampioni i qellimshëm
- Nxënës, prindër dhe mësues
- 61 Bashki

MBLEDHJA DHE ANALIZA E TË DHËNAVE

- Mbledhja në googleforms
- Përpunimi në SPSS

METODOLOGJIA



Kampioni

Shpërndarja sipas kategorisë

120926


75783

22881



■ Mësues (10.42%) ■ Nxënës (55.07%) ■ Prind (34.51%)

METODOLOGJIA



PAJISJA ELEKTRONIKE


nga e cila është plotësuar sondazhi

211095

4021

2517

1957




■ Kompjuter (tavoline) (0.89%) ■ Laptop (1.15%) ■ Smartphone (aparati celular) (96.13%) ■ Tablet (1.83%)

METODOLOGJIA


	DURRËS 1	KORÇË 2	FIER 3	LEZHË 4	
DPAP	86816	66914	42639	23221	
ZVAP	33856	16287	15346	12555	11855
	1 TIRANË	2 ELBASAN	3 DURRËS	4 FIER	5 BERAT

METODOLOGJIA


Shpërndarja sipas
qarqeve




Population




Shpërndarja sipas
DPAP



Population



03 REZULTATET E NXËNËSVE




■ Rurale (38.38%)
■ Urbane (61.62%)

Zona e shkollës

61.6%

e nxënësve ndjekin shkollën në **zonë urbane**.




■ Femër (59.58%) ■ Mashkull (40.42%)

Gjinia

59.6%

e nxënësve i përkasin gjinisë **femër**.




■ Private (5.23%)
■ Publike (94.77%)

Lloji i shkollës

94.8%

e nxënësve janë në **shkolla publike**.




■ Arsim Bazë (69.28%)
■ Gjimnaz (30.72%)

Cikli

70.2%


e nxënësve janë në **arsimin bazë**.

REZULTATET E NXËNËSVE




REZULTATET E NXËNËSVE

Profili i shkollës së nxënësve është (vetëm për nxënësit e klasave X, XI dhe XII)



REZULTATET E NXËNËSVE

Pajisja elektronike nga e cila kanë plotësuar nxënësit sondazhin



95.7%

Smartphone (aparar celular)

2.2%

Tablet

1.2%


Laptop

0.9%

Kompjuter (tavoline)

REZULTATET E NXËNËSVE


Përdorimi i platformave elektronike nga nxënësit



REZULTATET E NXËNËSVE

96%


e nxënësve janë vlerësuar nga mësuesit gjatë mësimit online ose në kushtet e shtëpisë.



Po (95.97%) Jo (4.03%)


98.3%

e nxënësve kanë zhvilluar testet/detyrat përmbledhëse dhe janë vlerësuar për detyrat e portofolit të kësaj periudhe.




Po (98.34%) Jo (1.66%)

REZULTATET E NXËNËSVE




Gjatë mësimit online, unë jam në gjendje të menaxhoj kohën time të studimit në mënyrë efektive dhe të mbaroj detyrat.

REZULTATET E NXËNËSVE




Si nxënës, mësimi online më pëlqen sepse kam më shumë mundësi të punoj në mënyrë të pavarur.

REZULTATET E NXËNËSVE




**Unë mund të bashkëpunoj,
diskutoj dhe punoj në grup
me shokët e mi të klasës,
gjatë veprimtarive të
mësimit online.**

REZULTATET E NXËNËSVE




Unë angazhohem maksimalisht për kryerjen e detyrave të dhëna nga mësuesit e mi, gjatë mësimit online.

REZULTATET E NXËNËSVE




**Unë u drejtoj pyetje
mësuesve të mi dhe marr
përgjigje të shpejtë nga ata,
për vështirësitë dhe
paqartësitë që kam në
lidhje me temat mësimore.**

REZULTATET E NXËNËSVE




**Unë ndjek video dhe
mësime online që më
sugjerohen nga mësuesit e
mi.**

REZULTATET E NXËNËSVE




Unë dërgoj detyra/ushtime/punime të ndryshme të kryera prej meje gjatë periudhës së qëndrimit në shtëpi, për të marrë komente nga mësuesi dhe nga shokët e mi të klasës.

REZULTATET E NXËNËSVE




Gjatë procesit mësimor online unë jo vetëm që kam përsëritur njohuritë e fituara më parë, por kam përvetësuar edhe njohuri të reja.

REZULTATET E NXËNËSVE




Videot e transmetuara në RTSH Shkolla më kanë ndihmuar gjatë mësimit në kushtet e shtëpisë.

REZULTATET E NXËNËSVE




**Unë vlerësohem nga
mësuesit e mi, dhe marr
komente të vlefshme për
detyrat ose ushtrimet që
kryej.**

REZULTATET E NXËNËSVE






Vlerësimet me teste dhe detyra përmbledhëse më kanë nxitur të përmirësoj arritjet dhe më kanë motivuar.

REZULTATET E NXËNËSVE



**Jam ndjerë mirë me format
e reja të vlerësimit online të
detyrave të portofolit.**

04 REZULTATET E PRINDËRVE



Punësimi

54.2%

e prindërve janë të punësuar.

Edukimi

37.1%


e prindërve janë me arsim të mesëm.

Statusi civil

94.9%


e prindërve janë të martuar.

REZULTATET E PRINDËRVE




REZULTATET E PRINDËRVE

Profili i shkollës së fëmijës është (vetëm për nxënësit e klasave X, XI dhe XII)



REZULTATET E PRINDËRVE

Pajisja elektronike nga e cila kanë plotësuar prindërit sondazhin



96.8% Smartphone (aparatur celular)


1.6% Tablet

0.8% Laptop

0.7% Kompjuter (tavoline)

REZULTATET E PRINDËRVE


Përdorimi i platformave elektronike nga fëmija



REZULTATET E PRINDËRVE

95.2%


e prindërve janë angazhuar në mësimet online me fëmijën.



Po (95.16%) Jo (4.84%)


92.8%

e prindërve janë informuar nga mësuesit në lidhje me vlerësimet e fëmijës, si dhe me rrugët për përmirësimin e tij.




Po (92.83%) Jo (7.17%)

REZULTATET E PRINDËRVE




Unë marr çdo informacion dhe jam në dijeni për çdo gjë që vjen nga drejtoria e shkollës dhe nga mësuesit e fëmijës tim.

REZULTATET E PRINDËRVE




Gjatë qëndrimit në shtëpi të fëmijës tim, unë si prind e mbështes atë në mësimin në kushtet e shtëpisë, duke lehtësuar marrjen e informacionit nga mësuesit.

REZULTATET E PRINDËRVE




Të mësuarit online ndihmon fëmijën tim për zhvillimin e kompetencës digjitale.

REZULTATET E PRINDËRVE




Të mësuarit online ka të njëjtën cilësi si procesi mësimor në klasë.

REZULTATET E PRINDËRVE




Të mësuarit në mënyrë elektronike ndikon në zhvillimin personal dhe social të fëmijës tim.

REZULTATET E PRINDËRVE




Fëmija im angazhohet maksimalisht për kryerjen e detyrave të dhëna nga mësuesit e tij.

REZULTATET E PRINDËRVE




Fëmija im punon në grup gjatë aktiviteteve të mësimit online.

REZULTATET E PRINDËRVE




Gjatë mësimit online, fëmija im mund të bëjë pyetje për mësuesin e tij dhe të marrë një përgjigje të shpejtë gjatë aktiviteteve mësimore.

REZULTATET E PRINDËRVE




Gjatë mësimit online, fëmija im jo vetëm që ka përsëritur njohuritë e fituara më parë, por edhe ka përvetësuar njohuri të reja.

REZULTATET E PRINDËRVE




Gjatë mësimit online, fëmija im merr vlerësime ose komente nga mësuesit për detyrat ose ushtrimet që kryen.

REZULTATET E PRINDËRVE



Testet përmbledhëse që fëmija im ka zhvilluar nëpërmjet komunikimit online, janë efektive.


REZULTATET E PRINDËRVE



Komentet dhe vlerësimet online e kanë bërë të ndjehet mirë dhe e kanë motivuar fëmijën tim.

05

REZULTATET E MËSUESVE



■ Rurale (47.33%)
■ Urbane (52.67%)

Zona e shkollës

52.7%

e mësuesve japin mësim në **zonë urbane**.




■ Femër (78.96%) ■ Mashkull (21.04%)

Gjinia

78.9%

e mësuesve i përkasin gjinisë **femër**.




■ Private (4.59%)
■ Publike (95.41%)

Lloji i shkollës

95.4%

e mësuesve japin mësim në **shkolla publike**.




■ Mësues lëndor (95.19%)
■ Mësues ndihmës (4.81%)

Mësues ndihmës

4.8%


e mësuesve janë **mësues ndihmës**.

REZULTATET E MËSUESVE




REZULTATET E MËSUESVE

Profili i shkollës ku japin mësim është (nëse janë mësues në shkollë të mesme)



REZULTATET E MËSUESVE

Pajisja elektronike nga e cila kanë plotësuar mësuesit sondazhin



95.9% Smartphone (aparar celular)


2.0% Laptop

1.3% Kompjuter (tavoline)

0.7% Tablet

REZULTATET E MËSUESVE


Përdorimi i platformave elektronike nga nxënësit



REZULTATET E MËSUESVE

97.3%


e mësuesve kanë kryer vlerësimin e vazhduar për periudhën e dytë.



Po (97.3%) Jo (2.7%)

91.5%

e mësuesve kanë përfshirë në vlerësimin e portofolit, detyra hulumtuese/krijuese që janë zhvilluar gjatë mësimit në kushtet e shtëpisë.




Po (91.54%) Jo (8.46%)

REZULTATET E MËSUESVE

96.9%


e mësuesve kanë kryer vlerësimin me test ose me detyrë përmbledhëse për periudhën e dytë.



Po (96.96%) Jo (3.04%)


92.3%

e mësuesve kanë informuar prindërit në lidhje me vlerësimet e fëmijës, si dhe me rrugët për përmirësimin e të nxënit.




Po (92.33%) Jo (7.67%)

REZULTATET E MËSUESVE




Komunikoj rregullisht me nxënësit, prindërit e tyre dhe drejtuesit e institucionit arsimor që nxënësit të jenë të angazhuar për mësimet në kushtet e shtëpisë.

REZULTATET E MËSUESVE




U drejtoj pyetje dhe u përgjigjem pyetjeve që bëjnë nxënësit në lidhje me temat mësimore, për vështirësitë dhe paqartësitë që ata kanë.

REZULTATET E MËSUESVE




Jap udhëzime në grupin e krijuar, në lidhje me përvetësimin e temës mësimore nëpërmjet mesazheve dhe videove të përgatitura.

REZULTATET E MËSUESVE




Jap detyra. Ushtrime, lexime plotësuese, kuizze etj. për temat mësimore, në varësi të specifikave të lëndës time.

REZULTATET E MËSUESVE



Shoh me përparësi ngarkesën e nxënësit me përmbajtjen mësimore, duke u fokusuar në njohuritë kryesore të reja dhe në përforcimin e njohurive të fituara deri tani.

REZULTATET E MËSUESVE




Aktivitetet/videot/audiot që sugjeroj për nxënësit në internet bazohen në programin lëndor.

REZULTATET E MËSUESVE




Mësimi është efektiv edhe pa ndërvepruar me nxënësit e mi ballë për ballë.

REZULTATET E MËSUESVE




Jam fleksibël në trajtimin e nevojave të nxënësve të mi, gjatë mësimit në kushtet e shtëpisë.

REZULTATET E MËSUESVE




Jam i kënaqur me angazhimin e nxënësve të mi gjatë procesit të mëimit online dhe i vlerësoj me fjalë dhe komente ata, në mënyrë që t'i motivoj për të nxënë.

REZULTATET E MËSUESVE




Jam i kënaqur me bashkëpunimin e prindërve të nxënësve të mi gjatë procesit të mësimit online.

REZULTATET E MËSUESVE




Mësimi online u mundëson fëmijëve të ndajnë shqetësime, probleme, Nevoja, diskutime që nuk kanë të bëjnë vetëm me të mësuarin, por dhe me çështje të tjera që ndikojnë në aspektin social-emocional të nxënësve.

REZULTATET E MËSUESVE




Kam përgatitur video, powerpoint etj., për orë mësimore dhe i kam shpërndarë ato me nxënësit dhe kolegët.

REZULTATET E MËSUESVE




Kam bërë vlerësime të nxënësit për detyrat e shtëpisë, punë të pavarur etj.

REZULTATET E MËSUESVE




Vlerësimi i nxënësve në kushtet e shtëpisë është fokusuar në njohuritë kryesore të reja dhe në përforcimin e njohurive të fituara deri tani, duke parë me përparësi ngarkesën e nxënësve.

REZULTATET E MËSUESVE




Gjatë mësimit në kushtet e shtëpisë kam mundësi të përdor instrumente dhe forma vlerësimi, të cilat janë në përputhje me nevojat e veçanta, karakteristikat dhe mundësitë e nxënësve.

REZULTATET E MËSUESVE




Komentet dhe vlerësimet online kanë motivuar nxënësit e mi dhe kanë nxitur përmirësimin e tyre.

REZULTATET E MËSUESVE




Testet përmbledhëse që u zhvilluan nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë me nxënësit, kanë qenë efektive dhe nuk kanë krijuar mbingarkesë të nxënësit.

REZULTATET E MËSUESVE



Jam i kënaqur me pjesëmarrjen dhe angazhimin e nxënësve në mënyrat e reja të vlerësimit të vazhduar, vlerësimit të portofolit dhe vlerësimit me test ose me detyrë përmbledhëse.

REZULTATET E MËSUESVE



Shfrytëzoj/përdor Udhëzuesit e përgatitur nga ASCAP dhe me kanë ndihmuar në punën time gjatë mësimit në kushte të shtëpisë.

SONDAZHI I MËSIMIT ONLINE 2



Prill, 2020

www.arsimi.gov.al
www.ascap.edu.al